



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/17
Prishtinë,më 5 qershor 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet **Hyseni**,anëtar i Kryesisë.

Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 94 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për planifikimin hapësinor-3003/15;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për skemën e ndihmës sociale-2003/116;
4. Parashtrimi i pyetjeve dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 12 qershor 2003.

Kryesuesi e përshëndeti delegacionin e Parlamentit të Landit Nidedersachsen të Gjermanisë,që ishin të pranishëm në seancë dhe deputetin e LKÇK-së,z.Smajl Latifi, që për herë të parë merrte pjesë në Kuvend.Ai kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Kryesuesi shprehu shqetsimin lidhur me vrasjen e tre qytetarëve të komunës së Kastriotit,të komunitetit serb,që kishte ndodhur ditë më parë dhe shtoi se të gjitha institucionet e Kosovës e kanë denuar këtë vrasje.Gjithashtu edhe Kuvendi i Kosovës e denon atë vrasje.

Dragisha Krstoviq në emër të koalicionit “Kthimi”e falenderoi kryesuesin për shqetësimin që shprehu në emër të Kuvendit lidhur me vrasjen e tre serbëve të pafajshëm.Ai kërkoi përgjësinë e kryetarit të Kosovës,të kryeministrit dhe të kreut të SHPK-së,si akt moral, për vrasjet që kanë ndodhur ndaj qytetarëve të komunitetit serb.z.Krstoviq kërkoi që Kuvendi të miratojë një deklaratë për denimin e këtij rasti, si dhe të mbajë një minutë heshtje.

Kryesuesi tha se Kuvendi e gjykon këtë rast dhe kërkon nga qytetarët e Kosovës që të bashkëpunojnë më organet e hetuesisë që të zbulohen kryesit e kësaj vrasje.Ka pasur edhe kërkesa të mëhershme,që të mbahet një minutë heshtje për vrasjen e qytetarëve të Kosovës,por Kuvendi, për hirë të stabilitetit politik nuk e ka praktikuar një gjë të tillë.

Dragisha Krstoviq tha se koalicioni “Kthimi” në shënjë proteste për këtë vrasje,do ta lëshojë këtë seancë dhe ata e lëshuan seancën.

Arsim Bajrami kërkoi që si çështje e ngutshme,në seancën e sotme ose në seancën e ardhshme,të shqyrtohet përgatitja e një platforme politike për Samitin e Selanikut, që do ta reprezentonte delegacioni i Kosovës.

Kryesuesi tha se kërkesën e kryetarit të Grupi Parlamentar të PDK-së,z.Arsim Bajrami, së pari duhet ta shqyrtojë Kryesia e Kuvendit,pastaj ajo të debatohet në seancën e ardhshme plenare.

Smajl Latifi i paraqiti vlerësimet dhe qëndrimet e LKÇK-së për zhvillimin e proçeseve politike në Kosovë.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për planifikimin hapësinor-2003/15.

Kryesuesi e ftoi minisrtin e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit hapësinor që ta arsyetonte këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Et’hem Çeku tha se ky P/ligj për nga përmbajtja dhe rëndësia e tij,në rendin juridik në Kosovës,është i karakterit sistemor.

Planifiki hapësinor dhe urbanistik paraqet njërin nga segmentet më të rëndësishëm të perspektivës zhvillimore në Kosovë. Qëllimet themelore të planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë, sipas këtij p/ligji, janë në përputhëshmëri me standardet ndërkombëtare, që vlen të theksohen tri elemente kryesore:

- Politika e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik duhet t'i kontribuojë konkurrencës dhe efikasitetit;
- Të ndihmohet kohezioni ekonomik dhe social në Kosovë;
- Të sigurohet konservimi i trashëgimisë natyrore e kulturore të mjedisit jetësor, si parakushte për një zhvillim të mirëfillt.

Detyrat kryesore për përmirësimin e strukturave hapësore janë:

- Krijimi i raporteve të reja në relacion fshat-qytet, ku do të përfshihet sigurimi i zhvillimit të gjithmbarshëm;
- Trajtimi i dallimeve rajonale, në kundërshtim të politikës gjithëpërfshirëse, me koncentrimin në zonat me nevojë zhvillimore apo në ato ku ka krizë serioze strukturore, por pa rrezikuar zhvillimin e rajoneve;
- Zbutja e problemeve të krijuara në kufij, si pasojë e hapjes së numrit më të madh të kalimeve kufitare, me ç'rast do të intensifikohet bashkëpunimi ndërkufitar me përmirësimin kualitativ të rrjetit rrugor;
- Zgjerimi i strukturës ekonomike dhe i asaj të punësuarve në fushat e monokulturës bujqësore dhe të qyteteve me vetëm një veprimtari prodhuese, me promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Qëllimi i planifikimit dhe i rregullimit të hapësirës së Kosovës parashihet të jetë realizimi i politikës dhe i strategjisë së zhvillimit ekonomik, demografik, social, teknologjik, kulturor dhe ekologjik të Kosovës.

Me këtë P/ligj parashihen dhe sigurohen procedurat të detyrimit dhe mundësitë e pjesëmarrjes së të gjithë shfrytëzuesve të hapësirës, të personave juridik, të gjyqtarëve dhe të zhfrytëzuesve të tjerë.

Ministri Etem Çeku, kërkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/ligj.

Opinionet, mendimet dhe vërejtjet e veta në këtë p/ligj i dhanë edhe këta deputet: Naim Maloku, Sala Ahmetaj, Arsim Bajrami, Haki Shatri, Ramadan Kelmendi, Zyhrije Maloku, Blerim Baruti, Exhlale Salihu, Esat Dauti, Xhelal Canzibaba, Sadik Idrizi dhe Fadil Kryeziu, që u janë bashkangjitur stenogramit.

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për	85,
Kundër	0,
Abstenime	0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për planifikimin hapësinor dhe ngarkoi komisionin funksional dhe komisionet kryesore të Kuvendit që ta shqyrtojnë këtë p/ligj në afat brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime lidhur me këtë p/ligj.

3.Shqyrtimi i parë i P/ligjit për skemën e ndihmës sociale – 2003/16 .

Kryesuesi e ftoi ministrin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale që ta arsyetonte këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit .

Ministri Ahmet Jusufi tha se pas vitit 1999 administrata e UNMIK-ut e zhvilloi një program emergjent të asistencës financiare për ato grupe sociale që kishin më së shumti nevojë. Kjo skemë e përkohëshme më vonë u zëvendësua me një skemë të re të asistencës sociale që ka filluar të zbatohet prej muajit maj të vitit 2000 dhe ende është në fuqi.

Mbi bazën e kësaj skeme është hartuar edhe ky p/ligj , por i modifikuar sa kanë lejuar mundësit e buxhetit të konsoliduar të Kosovës .

Standardet dhe normat evropiane parashohin pagesën e ndihmës sociale në baza individuale , mirëpo aktualisht në Kosovë një formë e tillë është e pamundshme nga se numri i antarëve të një familje mesatare në Kosovë është 6.3 anëtarë , kurse buxheti i Kosovës është i kufizuar .

Sipas skemës të deritanishme të ndihmës sociale , ndihmë i është dhënë 51 mijë familjeve me 181 mijë antarë dhe për gjdo muajë për këtë qëllim janë shpenzuar 2 milion e 690 mijë euro.

Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka hartuar këtë p/ligj në bashkëpunim me qendrat komunale për punë sociale, Bankën Botërore ,USID-in dhe një numër të OJQ-ëve.

Sipas këtij p/ligji të drejtën në ndihmë sociale e gëzojnë familjet që i plotësojnë dy kritere kryesore

a) kriteri jo financiar që përfshin përbërjen e familjes dhe gjendjen sociale të anëtarëve të saj dhe

b) kriterin financiar që përfshin të hyrat materiale siç janë: të hyrat e fituara dhe të pa fituara , qiraja , dërgesat e parave , pensionet nga jashtë , etj .

Ky p/ligj rregullon edhe mënyrën e paraqitjes së rregullorës të drejtën në ankesë , shqyrtimin e ankesave , periudhën e shfrytëzimit të ndihmës sociale , gjobat për dëshmi të rrejshme , administrimin , financimin , fshehtësin e informatës dhe zbatimin e tij.

Ministri Ahmet Isufi kërkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë p/ligj .

Opinionet , vërjetjet dhe sugjerimet në këtë p/ligj i dhanë këtë deputetë: Nafije Berisha , Flora Brovina, Zylfije Hundozi , Sabri Hamiti, Fetije Këpuska , Sabile Basha, Fatmir Sejdiu, Ibush Jonuzi , Sanije Alaj, Teuta Hadri , Remzije Nimani, Mevlyde Saraqi dhe Zylfi Merxha, që janë bashkamgjitur stenogramit .

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për	79,
Kundër	0,
Abstenime	0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për skemën e ndihmës sociale dhe ngarkoi komisionin funksional dhe komisionet kryesore të Kuvendit

që ta shqyrtojnë këtë p/ligj në afatin kohor prej tri javësh , pastaj t'i paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime lidhur me këtë p/ligj.

4.Parashtrimi i pyetjeve – përgjigjet e ministrave .

Deputeti Ismail Kurteshi i kishte parashtruar pyetje ministrin të Ministriës për Punë dhe Mirëqenie Sociale , **z.Ahmet Isufi** lidhur me punësimin e përsoneve me aftësi të kufizuara.

Ministri Ahmet Isufi ishte përgjigjur me shkrim në pyetjen e deputetit **Ismail Kurteshi** .

Deputeti Ismail Kurteshi i kishte parashtruar pyetje Ministrin për Kulturë , Rini , Sport dhe Çështje Rezidente lidhur me keqpërdorimin e Internetit nga të rinjtë për dukuri negative të shoqërisë.

Ministri Behxhet Brajshori ishte përgjigjur me shkrim në pyetjen e deputetit I.Kurteshi.

5.Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare .

Kryesuesi propozoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet me 12 qershorë 2003 , si vijon:

1. Çështja e privatizimit .

Bajrush Xhemali, në emër të Komisionit për Tregti dhe Industri kërkoi që në një të një nga seancat e ardhshme të vihet në rend dite shqyrtimi i gjendjes në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Kuvendi e miratoi propozimin e rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare .

Seanca përfundoi në orën 13:50 minuta .

Sekretari e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik **Nexhat DACI**